



AGROKOS

PANAIRI NDËRKOMBËTAR I
AGROBIZNESIT, USHQIMIT DHE PIJEVE

**PËRMBLEDHJE MBI PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË AGROBIZNESIT,
USHQIMIT DHE PIJEVE**

16 - 17 Tetor 2024

**Edicioni i 24
Salla 1 Tetori
Prishtinë**





Krejt po rriten me **AGROKOS!**



AGROKOS 2024, i mbajtur me datën 16 dhe 17 tetor në Sallën 1 Tetori në Prishtinë, shënoi edicionin e 24-të, duke forcuar pozicionin e tij si panairi kryesor i agrobiznesit, ushqimit dhe pijeve në Kosovë. Ngjarja e këtij viti theksoi pikat e forta rajonale të Kosovës, duke pritur 178 ekspozues nga Kosova, Shqipëria, Greqia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Sllovenia, Hungaria, Turqia, Italia dhe Gjermania ku tërhoqi mbi 12,000 vizitorë nga vendi dhe rajoni, duke e theksuar AGROKOS-in si një pikë kyçe takimi për agrobizneset vendase dhe ndërkombëtare.

Rrjetëzimi dhe zhvillimi i biznesit ishin njëra ndër pikat kryesore të panairit me takime B2B, B2C dhe B2G, duke krijuar mundësi të rëndësishme për bizneset vendase që të lidhen me blerësit ndërkombëtarë.

Pjesëmarrja e larmishme kontribuoi në forcimin e reputacionit të Kosovës si një qendër agrobiznesi, duke hapur rrugë të reja tregu dhe duke forcuar marrëdhëniet me partnerët evropianë.

AGROKOS 2024 demonstroi rolin e tij si panairi kryesor i agrobiznesit në Kosovë, duke nxitur inovacionin, bashkëpunimin rajonal dhe rritjen në sektorin bujqësor. Teksa AGROKOS pret me padurim përvjetorin e tij të 25-të në vitin 2025, ai mbetet i përkushtuar për të shërbyer si një platformë dinamike për përparimet në sektorin e agrobiznesit dhe ushqimit në Ballkan dhe më gjerë.

Behim Xhaba

CEO-Congress and Event Organization



Krejt po rriten me **AGROKOS!**



Ceremonia e hapjes

Ceremonia e hapjes bashkoi zyrtarë të qeverisë, ambasadorë e përfaqësues të ambasadave në Kosovë, liderë biznesesh dhe profesionist të fushës. Fjalimet e hapjes u përqendruan në rolin e AGROKOS-it si një platformë për rritje ekonomike dhe marrëdhënie diplomatike.



z. Albin Kurti

Kryeministri i Republikës së Kosovës

Panairi u hap zyrtarisht nga Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti. Gjatë fjalimit të tij, z. Kurti theksoi rëndësinë e këtij panairi si një platformë që bashkon agrobiznesin, arsimin dhe teknologjinë për të krijuar mundësi të reja zhvillimi për vendin tonë për një të ardhme të qëndrueshme për të gjithë sektorët e përfshirë.



z. Faton Peci

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhillimit Rural

Ministri z. Peci në fjalimin e tij ndër të tjerash potencoi vlerën e panairit si dëshmi e rëndësishme që sektori i bujqësisë dhe agro-ushqimorë ka për zhvillimin e vendit tonë.



AGROKOS

PANAIRI NDERKOMBETAR I
AGROBIZNESIT, USHQIMIT DHE PLEJVE

16-17 OCTOBER 2024

24TH EDITION

PRISHTINA - KOSOVA



Vizitat në panairin AGROKOS

Pas ceremonisë së hapjes së panairit, të gjithë folësit dhe të pranishmit vizituan kompanitë ekspozuese, duke i takuar ekspozuesit personalisht një nga një. Vizitat ishin një rast shumë i mirë që shërbyen për njohjen me të gjitha kompanitë, ku diskutuan për sukseset e arritjet, vështirësitë dhe nevojat e kompanive.





Grupet dhe Ekspozuesit në panairin AGROKOS

AGROKOS 2024 ofroi një ekspozitë të veçantë me një gamë të gjerë të ekspozuesve:



Pavijonet Shtetërore:

Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe Italia u përfaqësuan me pavijone të veçanta. Italia, duke marrë pjesë për të gjashtin vit radhazi, ofroi një gamë të produkteve ushqimore, ndërsa Mali i Zi dhe Bosnja ekspozuan produkte vendore të bizneseve të ndryshme në kuadër të Odave Ekonomike të tyre.



Përfaqësimi Vendor:

Komunat pjesëmarrëse përfshirë Prizrenin, Malishevën dhe Dragashin, paraqitën produkte të veçanta në panair, duke pasqyruar trashëgiminë bujqësore të Kosovës.



Sektorët e Industrisë:

Ekspozuesit përfshinin prodhues të produkteve të qumështit, mishit, pijeve, frutave, perimeve, plehrave organike, materialeve të paketimit dhe pajisjeve bujqësore, etj. Ngjarja u shërbeu si prodhuesve të mëdhenj ashtu edhe bizneseve të vogla rajonale



Organizatrat dhe Shoqatat Mbështetëse:

AGROKOS 2024 pati një pjesëmarrje të dukshme nga shoqata dhe organizata jofitimprurëse që mbështesin zhvillimin e agrobiznesit. Shoqata Organika, PePeKo, Mjedorës e Kosovës, Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7, Fondacioni Jahjaga, Fondacioni Drita dhe Care International, ndër të tjera, ofruan mbështetje dhe mundësi rrjetëzimi për ekspozuesit dhe vizitorët.



Aktivitetet paralele gjatë panairit

Aktivitetet paralele në kuadër të panairit AGROKOS 2024 ofruan një platformë të pasur për diskutime dhe shkëmbim idesh mbi çështjet kryesore në agrobiznes dhe zhvillimin rural.

Panelet e diskutimit përfshinë ekspertë të ndryshëm të agrobiznesit, përfaqësues të ekspozuesve dhe prezantime nga studentë të arsimit të lartë në Kosovë, duke krijuar një hapësirë të vlefshme për debat dhe rrjetëzim.



Panel diskutimi me temën:

Roli i panairëve të agrobiznesit në zhvillimin profesional dhe karrierën e Studentëve: Krijimi i udhëheqësve të ardhshëm të industrisë

Pjesëmarrja e institucioneve arsimore në këtë rast i fakulteteve të bujqësisë më drejtimet si: menaxhimi bujqësor, teknologjia ushqimore, hortikultura, veterinaria, etj., në panairët e agrobiznesit kanë një rëndësi të veçantë për zhvillimin e mëtejshëm të sektorit, për krijimin e lidhjeve të reja dhe për përfitime të dyanshme për studentet dhe bizneset. Paneli ishte i dizajnuar për të diskutuar mbi temat si më poshtë:

- Lidhja midis teorisë dhe praktikës
- Krijimi i urave midis edukimit dhe tregut të punës
- Rinia dhe Inovacioni, nxitja e inovacionit përmes hulumtimeve dhe qasja në teknologji të reja, dixhitalizimi dhe AI në Bujqësi.
- Rritja e bashkëpunimeve dhe projekteve të përbashkëta mes studentëve dhe bizneseve si për projekte të përbashkëta kërkimore, zhvillim produktesh ose përmirësim të praktikave bujqësore.
- Ndikimi në politikat publike dhe zhvillimi strategjik dhe sfidat e tregut të punës

Panelistët:

Prof. Asoc. Dr. Alltane Kryeziu

Universiteti Hasan Prishtina
Prodekane - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Prof. Sadik Maloku

Universiteti Ukshin Hoti - Prizren
Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

Prof. Ass. Afete Musliu

Kolegji publik ndërkombëtar i biznesit - Mitrovicë (IBCM)
Profesoreshë – Menaxhimi Mjedisor dhe Bujqësor

z. Abedin Selimaj

Universiteti Haxhi Zeka - Pejë
Drejtor i Qendrës për Zhvillim të Karrierës

znj. Shqipe Dreshaj

Shkolla e mesme Abdyl Frashëri - Prishtinë
Mësimdhënëse e praktikës profesionale



Panel diskutimi me temën:

Rëndësia e përfshirjes së grave në agrobiznes dhe zhvillimi rural i qëndrueshëm

Themelimi i bizneseve familjare nga gratë në fushën e ushqimit, pijeve dhe agrobiznesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tyre personal, të komunitetit dhe zhvillimin ekonomik, veçanërisht në rajonet me ekonomi të paqëndrueshme. Në këtë panel u diskutuan këto pika:

- Fuqizimi Ekonomik dhe Barazia Gjinore
- Forcimi i Ekonomive Lokale
- Inovacioni dhe Qëndrueshmëria
- Zhvillimi i Komunitetit

Panelistët:

znj. Lendita Kastrati

Drejtoreshë Ekzekutive
Dhoma Ekonomike e Grave të Kosovës - G7

znj. Rita Berisha

Care International

znj. Arlinda Zaimi

Project Manager
Fondacioni Jahjaga



Panel diskutimi me temën:

Agrobizneset Kosovare, investimet në agrobiznes dhe qasja në tregjet vendore dhe ndërkombëtare

Në këtë panel u trajtuan tema kyçe që lidhen me zhvillimin e agrobiznesit dhe mundësitë financiare për këtë sektor në Kosovë. Në këtë panel u diskutuan këto pika:

- **Investimet në agrobiznes dhe mundësitë e kreditimit** - Sigurimi i fondeve dhe mbështetja financiare për agrobizneset dhe mundësitë ekzistuese për kreditim dhe ndihmë financiare.
- **Tregu evropian dhe agrobizneset** - Tregu evropian për produktet bujqësore nga Kosova dhe rritja e eksportit dhe hyrjeve të reja në treg.
- **Mundësitë për investime të reja** - Potenciali për investime të reja në sektorin e agrobiznesit dhe nismat që duhet ndërmarrë për të inkurajuar rritjen e këtij sektori.

Diskutimi synoi identifikimin e mundësive dhe sfidave që përballen agrobizneset kosovare në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregun evropian, dhe identifikimin e strategjive më të mira për të mbështetur rritjen dhe investimet në këtë drejtim.

Panelistët:

z. Hartim Gashi


Drejtar ekzekutiv
Shoqata - PePeKo

z. Maliq Hoti

Prodhues
Kompania - Terra Food

z. Gezim Murseli

Prodhues
Kompania - Tradita jonë



Panel diskutimi me temën:

Politikat e Zhvillimit Rural dhe Zhvillimi i Infrastrukturës Rurale

Pjesëmarrja e drejtorive në këto panele ofroi mundësinë për të ndarë përvojat dhe për të diskutuar hapat e ardhshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale. Në këtë panel u diskutuan këto pika:

- **Strategjitë e Zhvillimit Bujqësor Lokal dhe Rajonal** - Përmirësimi i metodave dhe qasjes për zhvillimin e bujqësisë në nivel lokal.
- **Zhvillimi i Sipërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Bujqësi** - Mbështetja për rritjen dhe zhvillimin e SME-ve bujqësore, duke përfshirë trajnime dhe mbështetje financiare.
- **Politikat për Përfshirjen e Rinisë dhe Gruas në Bujqësi** - Diskutimi i iniciativave që ndihmojnë rininë dhe gratë të angazhohen në bujqësi dhe në zonat rurale.

Panelistët:

z. Qamil Kolloni

Drejtor për Ekonomi Financa dhe Zhvillim
Komuna e Dragashit

z. Afrim Tejeci

Kryetarë
Oda e Ndërmarrësve Zejtarrëve të Prizrenit

z. Sylë Dukolli

Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Komuna e Malishevës



Panel diskutimi me temën:

Trendët e Kultivimit të Pemëve të Imëta në Kosovë dhe Mundësitë e Zhvillimit të Tregut Evropian

Paneli u organizua nga Shoqata Nacionale e Pemëve të Imëta të Kosovës, e njohur si "Mjedra e Kosovës".

Në këtë panel u diskutuan:

- **Trendët e Kultivimit të Pemëve të Imëta në Kosovë** - Praktikrat dhe sfidat më të reja me të cilat përballen prodhuesit e pemëve të imëta dhe trendet aktuale të kultivimit.
- **Tregu Evropian për Pemët e Imëta** - Qëndrimi i tregut evropian për prodhimet nga Kosova dhe hapësira për zgjerimin e eksporteve.
- **Mundësitë për Investime të Reja** - Investimet e reja në sektorin e pemëve të imëta dhe mundësitë për të zgjeruar prodhimin.

Panelistët:

z. Kujtim Lepaja

Drejtor
Shoqata Mjedra e Kosovës

z. Blertan Libusha

Kompania - Beat Berries

z. Feim Ibishi

Kompania - Natural Fruits



Panel diskutimi me temën:

Bujqësia organike në Kosovë

Në panelin e diskutimit mbi bujqësinë organike në Kosovë, u theksua rëndësia e kësaj praktike si një mundësi e qëndrueshme për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve. Diskutimet u fokusuan në përfitimet e saj për mjedisin, duke ruajtur tokat dhe burimet natyrore përmes eliminimit të pesticideve dhe plehrave kimike, si dhe në sigurinë dhe cilësinë më të lartë të produkteve organike për konsumatorët.

Panelistët:

znj. Valdete Avdiu

Zyrtare e Lartë për Hortikulturë dhe Bujqësi Organike
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

z. Faton Nagavci

Drejtor
Shoqata Organika

znj. Arnita Veliu

Drejtuese
Botanic LLC



Prezantim Kolejji Publik Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë - IBCM

Në kuadër të AGROKOS, u prezantua një studim kërkimor nga znj. Dea Gaxha, përfaqësuese dhe ish studente e Kolejtit Publik Ndërkombëtar i Biznesit Mitrovicë - IBCM mbi "Eksplorimin e mundësive për biznese të qëndrueshme për prodhimin e sigurt të ushqimit në Kosovë", me fokus në arrat Tonda Gentile Romana. Prezantimi ofroi një pasqyrë të thellë mbi përfitimet dhe sfidat e këtij produkti në tregun kosovar, duke theksuar rëndësinë e praktikave të qëndrueshme dhe sigurisë ushqimore për zhvillimin e agribiznesit në rajon.




AGROKOS 2024: Mbështetja me bursa për studentët e dalluar

Në edicionin e 24-të, panairi AGROKOS vazhdoi me krenari traditën e tij shumëvjeçare për mbështetjen e studentëve të dalluar nga fusha të ndryshme që lidhen me sektorët e panairit. Si pjesë e këtij angazhimi, u ndanë tri bursa për studentët e përzgjedhur nga fusha të ndryshme që lidhen me temat dhe sektorët e përfaqësuar në panair.

Ceremonia e ndarjes së bursave u mbajt gjatë ditës së dytë të panairit, duke dëshmuar përkushtimin e AGROKOS për zhvillimin e gjeneratës së ardhshme të profesionistëve në agrobiznes dhe bujqësi. Këtë vit, na nderoi fakti që bursat iu ndanë tri studenteve të talentuara, duke dhënë një shembull të fuqishëm për fuqizimin e grave të reja në këto fusha kyçe.

Studentët jo vetëm që përfituan nga mbështetja financiare, por patën edhe mundësinë të krijojnë lidhje të rëndësishme me liderët e industrisë, të njihen me inovacionet më të fundit dhe të eksplorojnë perspektivat e ardhshme të karrierës së tyre.




Certifikata për pjesëmarrësit

Në përfundim të panairit, të gjithë ekspozuesit u nderuan me certifikata, duke njohur dhe vlerësuar angazhimin e tyre në këtë event të suksesshëm. Gjatë ceremonisë së organizuar në ditën e dytë të panairit, organizatorët shprehën mirënjohjen e tyre për kontributin dhe përpjekjet e çdo ekspozuesi, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe përkushtimit në arritjen e objektivave të përbashkëta.



Statistika dhe fakte AGROKOS 2024

Informata mbi ekspozuesit



Origjina e Ekspozuesve: Shqipëri, Itali, Gjermani, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Mali i Zi, Kroaci, Slloveni, Greqi dhe Turqi.

Informata mbi vizitorët

Panairi AGROKOS 2024 regjistroi një pjesëmarrje të jashtëzakonshme, duke mirëpritur gjithsej **12,976 vizitorë**, të ndarë si vijon:

Vizitorë Vendorë: **Më shumë se 10,000 vizitorë**

Vizitorë profesionist: 8.840


Vizitorë të përgjithshëm/publik: 1541

Vizitorë Ndërkombëtarë: **2,595 vizitorë nga 14 vende të ndryshme**

Vizitorë profesionist: 1914

Vizitorë të përgjithshëm/publik: 676

Origjina e Ekspozuesve: vijnë nga 14 vende të ndryshme, përfshirë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Greqinë, Italinë dhe Gjermaninë



AGROKOS 2024 dëshmoi rolin e tij si platformë kyçe për ndërlidhjen e industrisë dhe zhvillimin e bashkëpunimeve strategjike.

Përshtypjet e pjesëmarrësve

Ekspozuesit vlerësuan organizimin dhe mundësitë e rrjetëzimit të panairit. Duke u bazuar në suksesin e këtij viti, AGROKOS pret me entuziazëm edicionin e vitit 2025, duke synuar të zgjerojë partneritete ndërkombëtare dhe të pasurojë programin e ngjarjeve sektoriale. Përshtypjet nga ekspozues të ndryshëm theksuan rëndësinë e AGROKOS-it si një vend për bashkëpunim rajonal dhe rritje të biznesit.



Z. Mirsad Isarspahić

Kryetar i Dhomës Ekonomike të Bosnje dhe Hercegovinës

Ne jemi tradicionalisht prezent në këtë panair, sepse ne besojmë në këtë lidhje sektoriale mes dy vendeve. Ne mendojmë se jemi vërtet treg unik dhe duhet të bëjmë gjithcka për ta promovuar këtë treg unik midis rajonit CEFTA në përgjithësi.



Z. Eroll Erensor

ASB & ERENSOY & KM

Jemi këtu për herë të parë në Kosovë dhe si pjesëmarrës në panair këtu. Ne presim të takojmë konsumator të rinj në potencial në prodhimin e paketimeve plastike.



Znj. Zana Lika

Përfaqësuese nga Shoqata Organika

Arsyeja se pse kemi vendos me marr pjesë në këtë panair mendojmë që është një ndër eventet kryesore për bujqësi në Kosovë, gjithashtu ti shpalojmë dhe të jemi prezent me produkte organike të certifikuar me 6 kompani të cilat janë pjesëmarrëse dhe janë anëtarë



Z. Vladimir Bleksic

Këshilltar i Lartë për Bashkëpunim Nderkombëtar në Odën e Mallt të Zi

Kemi ardhur këtu për të ekspozuar bizneset nga vendi ynë, për të krijuar kontakte të reja me kompanitë kosovare, sepse kompanitë nga vendi ynë po planifikojnë të eksportojnë në Kosovë.



Z. Arli Janku

Drejtor Ekzekutiv nga kompania Lhyra Balkan

Tek panairi Agrokos ne kemi marr pjesë për shumë vite, ky është viti i tretë radhazi, dhe do vazhdojmë të marrim pjesë edhe në të ardhmen. Nga ky panair ne presim më së shumti takime biznesi për rritjen e mundshme të bashkëpunimeve në mes kompanive italiane dhe këtyre kosovare





Z. Saimir Begaj

Drejtor Ekzekutiv në kompaninë Erzeni

Kemi ardhur në panair për të prezantuar produktet tona, pasi ato tanimë janë pjesë e tavolinave të qytetarëve të Kosovës dhe njihen gjerësisht. Dëshirojmë që së shpejti të jemi prezent në tregun e Kosovës.



Z. Parid Cena

Student në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë

Ndihemi të privilegjuar që marrim pjesë në këtë panair që është kaq i madh dhe kaq shumë biznese. Pritshmëritë janë të larta për shkak që siç po e shohim ka numër të madh të bizneseve.



Znj. Dea Gaxha

Zyrtare e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në IBCM

Këtu jemi ardhë me ju tregu studentave dhe liderëve të ardhshëm më shumë për programet tona që i ofrojmë si kolegji.



Znj. Elona Kraba

Menaxhere Teknike dhe i Teknologjisë në 3AL LLC

Nga panairi presim të hyjmë në tregun e Kosovës, pra të njihemi edhe ne këtu me produktet vendase që kemi.



Znj. Zana Sahiti

Këshilltare për Sigurinë Ushqimore në PePeKo

Ne marrim pjesë në panairin AgroKos çdo vit, për arsye se panairi AgroKos e ka rendësin e vet dhe këtu vijmë bashkë me kompanitë anëtare të shoqatës. Këtë vit i kemi pasur 8 anëtarë përpunues të pemëve dhe perimeve të Kosovës anëtarë në panair. Duke i parë rezultatet edhe vitet përpara, lidhur me marrëveshjet, kompanitë kanë bërë marrëveshje të ndryshme dhe janë njoftuar në AgroKos, ne prandaj marrim pjesë çdo vit në këtë.



Z. Kujtim Lepaja

Drejtor Ekzekutiv në shoqatën Mjedia e Kosovës

Ne kemi vendosur të marrim pjesë në panairin AGROKOS, pasi kemi parë një mundësi të mirë për të prezantuar produktet e pemëve të imëta para qytetarëve tanë. Duke pasur parasysh që këto produkte janë të dedikuara kryesisht për eksport, interesi ynë ka qenë që ato të prezantohen edhe në vend, në mënyrë që qytetarët të kenë sa më shumë informacione rreth kultivimit dhe prodhimit të këtyre produkteve në Kosovë.



Pamje nga AGROKOS 2024





AGROKOS

PANAIRI NDËRKOMBËTAR I
AGROBIZNESIT, USHQIMIT DHE PIJEVE

Shihemi në edicionin e 25 të panairit ndërkombëtar të
Agrobiznesit, ushqimit dhe pijeve AGROKOS

27-28 Maj 2025
Salla 1 Tetori - Prishtinë

CEO - Congress and Event Organization

Mob: +383 44 629 916 | Mob: +383 46 444 420

Adresa: Rr. Emrush Miftari nr.14 - Velani, 10000 Prishtinë, Kosovë

info@ceokos.com | www.ceokos.com